

URDHËR
Nr. 157, datë 22.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 267, DATË 24.7.2019, “MBI MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR MËNYRËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E
KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Çdo subjekt që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese është i detyruar të aplikojë në portalin *e-Albania*, për pajisjen me certifikatë kategorizimit, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese.”

2. Në tekstin e rregullores të miratuar me urdhrin të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar bëhen ndryshime si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, të nenit 2, togfjalëshi “...brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të urdhrit të ministrit...”, hiqet;

b) Shkronja “a”, e pikës 1 të nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

“a) Faza e parë përfshin procesin e vetëdeklarimit të sipërmarrësit turistik, i cili konsiston në plotësimin e formularit të aplikimit në portalin *e-Albania* dhe ngarkimit të dokumentacionit shoqërues, të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.”

c) Pika 1 e nenit 5 ndryshohet si më poshtë:

“1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të aplikojë *online* në portalin *e-Albania* duke plotësuar formularin e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.”

ç) Neni 6 ndryshon si më poshtë:

“Subjekti plotëson formularin e aplikimit në portalin *e-Albania* dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;

b) vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

c) planimetrinë e strukturës akomoduese;

ç) vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;

d) vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjeno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;

dh) vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit/administratorit (dëshmi penaliteti).

ë) foto të brendshme dhe të jashtme të objektit;”

d) Në pikën 1 të nenit 7 togfjalëshi "...depozitimit të kërkesës, formularit të vetëdeklarimit..." zëvendësohet me togfjalëshin "...e plotësimit të formularit të aplikimit...".

dh) Në pikën 4 të nenit 7 togfjalëshi "... të formularit të vetëdeklarimit ..." zëvendësohet me togfjalëshin "...të formularit të aplikimit ...".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi